

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALTA TAXI” SH.P.K**

Sot, më datë 01/09/2024 (dy mijë e njezet e kater), **Z .Albert Aliaj** , shtetas shqiptar, i datëlindjes 01/06/1970, lindur në Ballsh,Fier dhe banues ne Tirane ,Rr,Frederik Shiroka ,pallati gora hyrja 3 ap 29 person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me id H00601142L Vendosem te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqerise eshte ALTA TAXI **Sh.P.K**, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri ALTA TAXI ” **SH.P.K**, sipas përcaktimeve të bera në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte zhvillimi I sherbime te transportit per pasagjer dhe cdo gje qe ka lidhje me kete sektor..

**NENI 3**  
**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin ” **ALTA TAXI** ” **SH.P.K**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është: Sherbim transporti per pasagjere brenda dhe jashte vendit.Cdo operacion te ngjashem dhe te lejuar nga legjislacioni shqiptar .

**NENI 5**  
**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në bashkine Tirane , Adresa Tirane Njesia Nr.7 Rruga “Frederik Shiroka” pallati gora hyrja 3 ap 29 zhvillon aktivitetin e tij për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**  
**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 2.000.000 (dy milion) lek, Ortaku themelues z **Albert Aliaj** te Shoqërisë Tregtare “**ALTA TAXI**” **SH.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:**ZAlbert Aliaj** , shtetase shqiptar, i datëlindjes 01/06/1970 lindur në Ballsh ,Fier dhe banues në Tirane ,RrFrederik Shiroka pallati gora hyrja 3 ap 29 , mbajtës i kartes me id H00601142L zotërues i kuotave 100 % të përbërë nga 2.000.000(dy milion) lek, duke përfaqesuar 100 %, të kapitalit Kapitali themeltar eshte shlyer plotesisht ne para nga Ortaket me themelimin e Shoqerise. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar



**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

**NENI 8**  
**Administratori**

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë Z Albert Aliaj shtetas shqiptar i datelindjes 01/06/1970 lindur në Ballsh Fier, dhe banues në Tirane, Rr. Frederik Shiroka mbajtes I kartes me ID H00601142L shtetas Shqiptar,

**NENI 9**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, te cili ushtronë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 13**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

**NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU THEMELUES**  
**ALBERT ALIAJ**

